

ADRIATIKE LAMI

HISTORIA DHE TIPARE TË PROZËS SË SHKURTËR SHQIPE NË FILLIMIN E SHEKULLIT XX PËRMES TIPAREVE TË PROZËS SË LUMO SKËNDOS

Proza e Lumo Skëndos dhe letërsia shqipe

Të parët e letërsisë shqipe dhe prozës së kësaj kohe përmes veprës së Skëndos, ndodh edhe pse me prozën e tij zë fill proza e mirëfilltë shqipe.

Krijimtarinë e Lumo Skëndos studiuesi Nasho Jorgaqi e lidh me situatën e jetës shqiptare, e cila kishte nevojë për hapësirë dhe dimension, të cilën nuk mund t'ia jepte më vetëm poezia. Nuk është e rastit kurrësi kjo fillesë me këtë lloj proze. Lumo Skëndo u shfaq në letërsinë shqipe në fundin e Rilindjes. Në këtë kohë kishte nevojë për shumë shprehje dhe shumë sfond. Këtë mundësi e shfrytëzoi Lumo Skëndo. Natyrisht terreni ishte jo shumë i lehtë. Këtë mosfavorizim e realizonte mungesa e traditës në letërsinë shqipe të prozës si edhe konturi individual i paprovuar. Natyra si Lumo Skëndo nuk mund të dështonin në iniciativat e tyre. E konsideruar e tillë, ajo nuk mbeti thjesht kështu. Edhe pas kaq vitesh ai na ka dhënë një libër që lexohet me mjaft lehtësi dhe kënaqësi estetike, siç është “Hi dhe Shpuzë”. Proza e Lumo Skëndos do të vazhdojë të shihet e lidhur me krijimtarinë e Faik Konicës, Koliqit, Migjenit, Kutelit, Camajt e Mihal Hanxharit.

Po kështu Lumo Skëndo mund të klasifikohet ndër autorët veprues, përkundrejt qëllimit të artit të tij, njësoj si De Rada, Naimi, Skiroi, Fishta, Kadare, etj.

Vepra e tij në prozë vjen menjëherë pas tregimit të parë në gjuhën shqipe: “Gjahut të malësorëve” të K. Kristoforidhit, i cili shfaqet në dy variantet e shqipes.

Dhe Nasho Jorgaqi sërish vazhdon për prozën e Skëndos: “*Ishte fjala për një prozë të mirëfilltë artistike, larg rutinës së prozës së deriat’hershme, për t’u ngritur mbi prozën publicistike. Proza duhej*

të kalonte nga hapësirat e një informacioni logjik dhe të shprehjes së zakonshme në hapësirat emocionale dhe të një shprehjeje të ngritur. Lumo Skëndo do të ishte nga të paktët që do të kontribonte, përmes një proze të vërtetë artistike, që të arrihej ky kapërcim cilësor në letërsinë shqipe. Dhe proza e tij do të fitonte këto vlera falë, jo vetëm trajtimit të temave nga jeta shqiptare dhe mbrujtjes së tyre me idetë e Rilindjes Kombëtare, por edhe të mjeshtërisë artistike, të zbulimit të karaktereve, të thurjes së situatave e të përfuturit të një atmosfere të besueshme, të strukturave të ndryshme kompozicionale. Të gjitha këto ai do t'i shprehte dhe mishëronte artistikisht nëpërmjet një gjuhe emocionale dhe individualizuese. Kështu, proza shqipe në pendën e Lumo Skëndos do të njihnte disa nga faqet e saj të para të suksesshme”.

Disa tipare të përgjithshme të prozës së Lumo Skëndos, me dhe pa librin “Hi dhe Shpuzë”

Proza e mirëfilltë letrare e Lumo Skëndos nis me tregimin e tij “përpara luleve të Shegës”, që në fakt mbeti i pabotuar. Më pas krijimtaria e tij u shoqërua nga skica poetike, tregime të tjera, novela, një pjesë të cilave ai i mblodhi te libri “Hi dhe shpuzë.” Kujdesin e tij ndaj kësaj krijimtarije e dëshmon vetë autori në fillimin e këtij libri, ku do të parathotë: “...tani po i shtyp këtu të pandërtuara, me atë kujdes që e bën njerinë të dojë ruajtjen e kujtimeve të tij që e bën të shtrëngohetë për të përsëriturë gjyratë gjysmë të shuara”.

Proza artistike e Lumo Skëndos vjen emocionuese, novatore, moderne. Ajo shënoi një kthesë dhe një hop cilësor në letërsinë shqipe dhe që me një ndikim mjaft të madh në letërsinë dhe shkrimtarët e kohës së tij. Së bashku me Faik Konicën, Lumo Skëndo që i pari, që lëvroi prozën e shkurtër artistike. Ajo u shfaq si një risi e letërsisë sonë, si një pjekuri e saj. Një kapërcim siç quhet ndryshe nga poezia tek proza. Ndërsa te Konica prozat janë përshkruese tek Lumo Skëndo janë humane. Prozat e tij vënë në qendër njeriun me të gjitha atributet e tij, të mirat dhe të këqijat, thelbin dhe elementët anësorë, përkushtimin dhe anashkalimin, heshtjen dhe vrullin apo shpërthimin. Duhet thënë që ky dallim

midis prozës së tij dhe asaj të Lumo Skëndos është një dallim, i cili në fakt ndërton specifikën e tij në prozë, specifikë e cila është e lidhur së pari me kronizimin e situatave, problemeve të ditës. Por secili prej tyre ka nga një kontribut specifik që më pas ndërtoi atë që ne e quajmë vazhdimësi në traditën e shkrimit të shqipes. Këta dy autorë krijuan atë gjini për të cilën kishte nevojë Shqipëria. Prozat e Lumo Skëndos, Uran Butka do t'i klasifikonte si proza të "fiksionit", me pak fjalë, si proza që ndërtohen nga një pamje, imazh, krijim. Por nuk jam duke thënë fantazi dhe as veprim. Kjo është një prozë midis veprimit dhe fantazisë. Veprimi kuptohet si një kriter artistik.

Veprimi këtu shoqërohet nga elementi i rrezikut artistik dhe ai i dilemës njerëzore. Ndërmjetësi që është autori reflekton guxim dhe qëndrueshmëri për të cilën ka nevojë paraqitja e prozës.

Proza e tij para së gjithash klasifikohet e shkurtër. Koncize. Ndoshta ky lloj përcaktimi luan rol jo vetëm për të vënë në dukje sasinë në rreshta por programacionin e mendimit mbi të dhënë dhe faktin. Është e rëndësishme të lodrojmë rreth kësaj. Meqenëse në punën time mbi këtë autor kam zgjedhur metodën e rikthimit një për një pas komentit të përgjithshëm marr përsipër ta trajtoj këtë detaj cilësie në trajtimin e prozave të shkurtra të Tij. Ajo që do desha të realizoja nëpërmjet emërimit prozë e shkurtër është shija e moslodhjes dhe e kënaqësisë në kohë që të japin këto proza. Por veçantia e konciziteti është e lidhur edhe me ekonominë gjuhësore të diskutuar kaq shumë në strukturalizëm, e cila të çon në kuptueshmëri më të mirë dhe veçanërisht në kuptueshmëri masive. Lumo Skëndo kishte një detyrë dhe një përgjegjësi kombëtare. Ai duhej të transmetonte ide, fakte mesazhe. Kështu që zgjedhja e elementit të shkurtësisë ndihmon në realizimin e këtij kontributi. Do doja të dalloja gjithashtu që shkurtësia vetë si produkt të lejon mundësinë e rileximit, i cili vetë realizon ngulitjen dhe kapërcimin kuptimor. Shpesh e përdor termin kumtim, shije, etj. Natyrisht që kjo ka një qëllim. Qëllimi është që të dalin hap pas hapi (me këtë nuk kuptoj kronologjinë), tiparet e veprës së Lumo Skëndos.

Proza e tij është e figurshme. Ky tipar është shoqërues i stilit të Lumo Skëndos, por edhe i natyrës së prozës që ai prezanton. Por kjo natyrisht që është atribut edhe i një fakti, që "vuan" nga butësia e

figurës. Figura në duart e lumo Skëndos ledhatohet, jo vetëm kaq, ajo arrin të prezantojë veten si pjesë të një mentaliteti e tradite të pastër dhe plot shije. Lumo Skëndo është një njohës, i përkryer i kësaj tradite (shqiptare), kështu që ai edhe pjesë e suportit letrar, ku ai aderoi. Në të njëjtën kohë proza e tij ka shenjat e para të modernitetit, të një proze moderne, e cila do të shoqërohet me kuadratin e elementit të figurshëm. Por thamë që kjo prozë është edhe novatore, sepse është e para e llojit të vet në Shqipëri. Modelin e tij do ta ndjekin prozatorët e mëvonshëm shqiptarë, të cilët do të gjejnë te prozat e Lumo Skëndos burimin e vërtetë të fillesës së kësaj proze. Madje një burim të patrazuar dhe mjaft të qartë. Nga ana tjetër kjo prozë është një reflektim shpirtëror, e brendshme dhe me aktivizime të syrit dhe të të gjitha shqisave artistike. Në prozat e Skëndos ka një tematikë që unë do ta klasifikoja edhe të larmishme, por edhe të specifikuar. Në të zotërojnë tema të tilla si dashuria, hakmarrja, ndarja. Në mënyrë të veçantë temën e dashurisë te prozat e Lumo Skëndos, dhe në përgjithësi të tematikës së tij e ka trajtuar Nasho Jorgaqi te libri i tij i fundit: “Or’ e fundit” që i dedikohet pikërisht Lumo Skëndos. Do të jap disa citime mbi tematikën e këtyre prozave nga ky autor:

“Temat zotëruese janë temat tipike të kohës, ato të pajtimit e të bashkimit kombëtar, lufta kundër gjakmarrjes dhe mercenarizmit, qëndresa ndaj dhunës së administratës osmane, demaskimi i mizorisë dhe lakmive të fqinjëve shovenë, përndjekja e librit shqip, evokimi dhe glorifikimi i simboleve të shqiptarëve...”

Ndërsa veçanërisht për temën e dashurisë ai do të shprehet: “Dashuria te prozat e Lumo Skëndos nuk mund të përfytyrohet e kuptohet pa pjesëmarrjen aktive të natyrës. Natyra është pjesë përbërëse dhe sfond i pandarë i saj. Ajo i gjendet dashurisë së shkrimtarit në çdo kohë të ditës dhe të natës, mbushur me mistere dhe kredhur në një atmosferë të mjegulluar. Në peizazhin e tij janë të pranishëm zakonisht qielli, hëna, nata, mugëtira, shiu, vjeshta, drita të vagulluara, që në një mënyrë a në një tjetër, ndihmojnë për të nxjerrë në reliev momente të ndryshme të dashurisë.

Marrëdhënia midis dashurisë është një marrëdhënie figurative. Diku ka ndriçim, diku tjetër ka hije. Drita dhe hija janë sunduese të këtij trajtimi. E parë kështu ajo dominohet nga dallesa si edhe nga distanca e të parit të gjërave, të një njeriu që i ka provuar vetë më parë dhe në fakt ka nxjerrë mësim (artistike) nga gabimet ose anashkalimet e veta. Kjo mënyrë përcjelljeje i jep prozës së Lumo Skëndos dëshirën për ta bërë atë tënden dhe për të thënë: Këtu në fakt duhet të jem edhe unë”.

Përshkrimi është elementi që në fakt ne e lidhim me natyrën, por nuk është vetëm tipar i përshkrimit të natyrës. Diku ai thotë: *“Eja mike, se po bie shi/Më duket sikur qielli po qan/Edhe zemra ime sot po qan. Jam vetëm. Lotët e qiellit rrjedhin jashtë qelqevet dhe po ndjej të ftohtë Brenda në zemër. E mban mend mike kur ishim bashkë sa shumë e donim shine. E mban mend gazin që ndjenim afër dritares kur binin pikat e mëdha të shiut. Ti i prisje ato ditë, se e dinje që më pëlqenin i prisnje ato ditë më prisnje mua. Atëherë kur bota të mbytej në lotë, ne ishim të gëzuarë, ahëre kur bota mbulohej me ujë të ftohtë ne kishim të nxehtë në zemër*

Po tani, nga kjo odë, gjysmëshikoj pikat që po kullojnë dhe po mbërdhij.”

Në prozën e gjatë, Lumo Skëndo mbështetet totalisht në materialin e mjedisit shqiptar. Ai karakterizohet nga dominimi i problemeve të mëdha të kohës, probleme të cilat Lumo Skëndo i njihte mjaft mirë edhe për shkak të angazhimeve të tij të drejtpërdrejta. Kjo lloj proze del si prozë e emocionit sikundër edhe proza e tij e shkurtër por në fakt edhe si prozë e meditimit, sikundër simotrat e tij europiane. Me këto proza fillimisht do të vëmë në dukje kontributet tematike. Temat e këtyre prozave janë marrë nga jeta shqiptare, ato kanë karakter të thellë social,moral shpirtëror. Po ta shikojmë me vëmendje Lumo Skëndo trajton temat dyshe, në mënyrë që të ketë mundësi meditimi dhe përshkrimi, krahasimi dhe konkludimi. Është shumë e rëndësishme të kuptohet roli qëndrues ndaj faktit që këtu jepet i shkrirë me mendimin e autorit. Lumo Skëndo për herë të parë në prozat e gjata fut elementin e subjektit dhe të personazhit. Ai merret në mënyrë të veçantë me trajtimin e psikologjisë së personazheve të veta, duke inkurajuar stilin realist,

që zëvendëson dalëngadalë paraqitjen romantike. Në shumicën e prozave të tij shkojnë bashkë tema, personazhi, psikologjia, veprimi dhe ëndërrimi.

Kujtimet e Lumo Skëndos do të jenë një tjetër zhanër, të cilin ai e lëvroi me mjaft sukses.

Ai do të jetë dëshmitar i të gjitha lëvizjeve të mëdha të kohës. Kështu që kjo i bën kujtimet e Lumo Skëndos me mjaft vlerë jo vetëm në aspektin historik, por sidomos në syrin e dëshmitarit, e dëshmitarit që ka qenë m'u në zemër të ngjarjeve, e dëshmitarit objektiv, që kërkon nëpërmjet gjërave që nuk kanë shkuar mirë të ndërtojë të mirat e përbashkëta. Kujtimet e Lumo Skëndos kanë karakter të veçantë. Ato janë së pari mjaft poetike. Ato karakterizohen nga figuracioni i goditur, nga kujdesi i fjalës. Ato gjithashtu janë mjaft filozofike. Të tilla janë prozat; Netët, Suljotët, Pylli, Kujtimet e një librari etj.

Portretet janë një tjetër lloj proze e lëvruar nga Lumo Skëndo. Është mjaft interesante këndvështrimi i trajtimit të këtyre figurave, këndvështrim, i cili i jep këto tipare kësaj gjinie; Së pari objektivitetin, humorin, mosidealizimin. Kështu ai nuk i sheh me përmasa të pabesueshme veprimet e personazheve të tij, por përkundrazi i jep ato me një sens humori, edhe ndonjë të metë që reflekton aspektin e natyrshëm njerëzor.

E gjithë kjo na çon në një tjetër lëvrim të Lumo Skëndos në atë të **mbresave të udhëtimit**, në të cilën Lumo Skëndo ishte përsëri i pari në letërsinë shqipe. Vlera e udhëpërshkrimeve qëndron në dy drejtime: në informacionin që ato sjellin për njerëzit, ambientet, etnografinë, historinë, dhe së dyti për natyrën e veçantë meditative.

Fjalët e urta karakterizohen nga moralizimi i drejtpërdrejtë, nga vendosja përballë njëra-tjetrës e fakteve të ngjashme dhe paralele. Në të njëjtën kohë ai përpiqet që moralin e transmetueshëm t'u shërbejë të gjithëve.

Mjaft interesante është edhe rubrika e **letërkëmbimeve** të Lumo Skëndos. Duke qenë një figurë komplekse dhe një figurë e cila ka dhënë kaq shumë në disa fusha të letërsisë dhe të kulturës e diplomacisë shqiptare, ai ka pasur marrëdhënie personale dhe pune me personalitete shqiptare dhe të huaja. Lumo Skëndo na jep një

korrespondencë fantastike me një pjesë të mirë të këtyre lidhjeve. Pjesa më e madhe e letërkëmbimit është për çështjen shqiptare. Forma e drejtpërdrejtë e ligjërimit të krijon idenë e një vërtetësisë dhe të lirshmërisë së shprehjes.

Marrëdhënia e udhëpërshkrimit me prozën e mirëfilltë

Në fakt konsiderohet i vështirë trajtimi i marrëdhënieve midis krijimeve në formën e letrave dhe prozave të Lumo Skëndos. Kjo lloj vështirësie lehtësohet së pari nga vetë kategorizimi që i bën autori. Të parat ai i quan udhëpërshkrime, ndërsa të dytat kujtime dhe novela. Ai do të thotë: *“Tani po i shtyp këtu të pandërruara, me atë kujdes që e bën njerinë të dojë ruajtjen e kujtimeve të tij, që e bën të shtrëngohet për të përsëritur ngjyrat gjysmë të shuara., dhe “më duket se shëtitja të dalët jashtë dhe të parët, do të jetë mësimi më i mirë për ne shqiptarët, që të marrin një kuptim të drejtë prej rojtjes dhe jetës. Do të jem i lumtur në qoftë se këto fletë të paka, zgjojnë midis shqiptarëve dëshirën e udhëtimeve dhe të shëtitjeve me qëllim që të shohin dhe të njohin”.*

Në marrëdhënie me prozën moderne

Konceptin e prozës moderne e gjejmë mbas Rilindjes Kombëtare dhe për herë të parë në letërsinë shqipe e përdori Eqrem Çabej, kur shkroi për Lasgush Poradecin. Në këtë kuadër vepra e tij ka përdorimin e treguesit etik si edhe përdorimin e idesë si angazhim. Një tipar tjetër është vënia në qendër e njeriut. Kjo lloj cilësie karakterizohet nga veçantia e zbulimit dhe e elementit të të papriturës. Ai në prozën e tij nisat nga një gjendje dhe përfundon në një gjendje tjetër. E gjitha kjo ndodh pa e përgatitur lexuesin për pasojën e radhës. Kështu ajo fiton një tregues të ri, që është treguesi i së papriturës. Një tjetër tipar që e lidh prozën e Lumo Skëndos me modernitetin është poetika pjesëmarrëse në prozat e tij. Prozat e Lumo Skëndos, nuk kanë ndodhi të mirëfilltë. Aty mungon ngjarja tradicionale, e cila ka një hyrje një zhvillim dhe një fund. Këtu kemi proza të cilat kanë një gjendje të caktuar. Dhënia e prozave deri te gjendja e bën prozën të ndjeshme dhe mjaft emocionale. Në këto proza ka lëvizje. Lëvizja këtu merret si tipar i modernitetit në

mungesë të subjektit të mirëfilltë. Në këtë kuadër nuk është e rastësishme që proza shqipe do t'i hedhë hapat e saj të parë me llojet e shkurtra, me skica, tregime, proza poetike, portrete, rrëfenja, tregime etj.

Midis prozës dhe poezisë

Proza e Lumo Skëndos është shkruar nën ndikimin e romantizmit dhe karakterizohet nga: lloji i gjinisë, notat lirike, sentimentalizmi, notat e peizazhit, vetia e ndërthurjes, qenësia e fjalës së këndshme, dominimi i natyrës, etj. Ky është libri i parë shqip, që synon organizimin strukturor dhe atë të zhanrit. Ajo shënon kapërcimin nga poezia në prozë. Ai karakterizohet nga ndërgjegjja dhe qartësia mbi atë çfarë po krijonte. Pasi vetë Lumo Skëndo e ndan librin “Hi dhe Shpuzë” në nënzhanre. Ai së pari dallon; prozat poetike, novelat, kujtimet.

Çfarë i dallon dhe ku ngjajnë këto ndarje

Kanë dallimin zhanror, që vetë Lumo Skëndo u ka bërë atyre. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me kronologjinë, por edhe me grupin duke ia bërë edhe emërtimet përkatëse. Të parat quhen proza të shkurtra, të dytat quhen novela, të tretat quhen kujtime. Është mjaft e rëndësishme ekzistenca e tyre së bashku sikundër janë të rëndësishme edhe fakti i grupimit sipas nënllujt. Rëndësia e parë është e lidhur me titullin e përbashkët “Hi dhe Shpuzë”. Të gjitha ato janë proza dhe nga proza e parë deri tek e fundit kemi ndjesinë e mrekullueshme që di të japë proza. Ndjesinë e përfuturit të përmasës së mendimit. Në këtë rast kjo përmasë është shtrirë në tre linja të cilat kanë një origjinë të përbashkët. Origjina është detaji. Të gjitha ato nisin nga një detaj të cilin Lumo Skëndo e ka përdorur njësoj si gjahtari përdor një element për të ndjellë gjuhën e tij. Kjo origjinë e përbashkët e bën këtë prozë të ndjehet e lidhur me pjesët e vetes, siç ndodh në të vërtetë në një poezi a poemë, por në të njëjtën kohë kjo origjinë e përbashkët shëmbëllen qartë rrugët dhe destinacionet e ndryshme të prozave. Përveç këtij burimi këto proza kanë edhe një gjendje të përbashkët, e cila më shumë është e lidhur me gjendjen e prehjes nga e cila njeriu merr forcën për lëvizje dhe nga e cila njeriu

përsëri merr dhe fiton aftësinë për të vëzhguar me vëmendje ose siç quhet në letërsi për të medituar. Aftësia e gjendjes së prehjes dhe aftësia e meditimit është përdorur nga autori si pjesë e formësimit të tiparit bazë për prozën e tij. Pa këto elementë proza e Lumo Skëndos nuk do të ishte shënjuese e fillimit të vërtetë të prozës shqipe dhe nuk do të ishte shënjuese e vërtetë e asaj cilësie që buron nga përftesa e të lexuarit.

Nga ana tjetër këto proza shijohen gjatë leximit. Pavarësisht notave të trishtimit dhe lumturisë që këtu në përgjithësi shkojnë bashkë kjo lloj proze të jep në radhë të parë përftesë estetike. Kjo lloj përftese mbahet mend edhe kur krijon një lloj distance me këtë prozë. Nga ana tjetër duhet thënë që proza e Lumo Skëndos fiton dalëngadalë vetinë e lëvizjes veti që e bën atë të jetë përshkrimore, duke reflektuar sidomos drejt natyrës. Përshkrimi dhe natyra ose përshkrimi i natyrës e bën këtë prozë që në vetvete të thurë detajin deri në hollësi natyraliste. Ky detajim është i rëndësishëm për të thyer tematikat që për Lumo Skëndon nuk kanë rëndësi më vete.

Kjo tematikë mbështetet fort në detaje, në përshkrime, në elementin e të papriturës në fantazinë e autorit dhe mbi të gjitha në portretizime. Tematika nuk ka rol thelbësor dhe më vete. Roli i saj është futës në situatë dhe përftues artistik. E gjithë kjo tundon rritjen e aspektit emocional dhe vendosjen e ekuilibrit midis dy emocioneve të ndryshme. Dy pamjet emocionale i shoqërojnë shpesh prozat e Lumo Skëndos. Ato janë dy pamje njësoj sikur kemi dualizëm në çdo koncept artistik të Lumo Skëndos. Dualizmi i tij ka vlerë artistike, sepse i jep prozës vlerën e kontrastit dhe për më tepër e bën të ndjehet e personazhuar edhe kur nuk ka personazhe ose ka njërin prej tyre. Dypamësia e koncepteve është në fakt një koncept romantik, tipar që ndjehet në këtë prozë.

Kjo veti nuk e bën aspak qaramane prozën e tij, por e thjeshton diferencën dhe e bën të kuptueshëm përdorimin e detajit a të konceptit. Kështu thjeshtësia dhe kuptueshmëria janë të tjera aspekte të kësaj proze. Këtu përmendëm edhe termin koncept. I gjithë konceptualizmi i tij provon të qenin dhe afrimin me shkollat artistike perëndimore, ku proza kishte filluar të merrte attribute moderniteti. Kështu konceptualizmi i Lumo Skëndos mesa duket fillon t'i japë

prozës së tij vetinë e modernitetit. Kjo lloj ngjashmëri ose këto veti të përbashkëta natyrisht nuk shihen identike nga njëra gjini te tjetra. Të mos harrojmë se prozat e shkurtra janë thjeshtë prozë e detajit, prehjes, e krijimit të imazhit, e njëkonceptueshmërisë. Ai këtu merret vetëm me një temë ose vetëm me një koncept. Kjo lloj lidhje e vendos këtë prozë në llojin e gjinisë që afron shumë me poezinë. Ajo ofron shije të momentit deri edhe elementë recitative, që pasqyrohen në pashtrmat dhe në thirrjet e forta shpirtërore. Emocionaliteti i lë këto akoma më shumë te fryma e poezisë. Novelat janë ndërtuar me një strukturë të copëtuar, por që është natyrë e një proze më të gjatë. Ato lejojnë hapësirë të mendimit, të temës, të detajit, të përshkrimit dhe të figurës. Shtrirja e kësaj proze e bën atë të jetë meditative dhe mjaft e mbështetur në konceptin që trajton. Figuracioni këtu është i pastër, por në të njëjtën kohë këtu kemi fragmentarizëm, mënyrë jo detyruesisht kronologjike e lidhjes së pjesëve brenda të njëjtës prozë ose fragment. Kjo e bën prozën të duket si një poemë me pjesë, pra megjithëqë këto konsiderohen novela, shumë mirë ngjajnë në detaje të caktuara me poemat, duke ruajtur kështu ndonjë më pak natyrën e poezisë në prozë. Ndërsa kujtimet janë ndërtuar mbi retrospektivën dhe mbi shembullin. Kjo e bën këtë gjini të jetë shpjeguese, tipar i prozës dhe në të njëjtën kohë të jetë mjaft personale, sepse pjesa e retrospektives kërkon imtësi, por jo detyruesisht verifikimin e imtësisë.

Sistemi i informacionit

Lumo Skëndo krijoi skica të shkurtra, novela, duke u bërë së bashku me Faik Konicën themeluesi i prozës së shkurtër shqipe. Si një risi pasi derimë atë kohë vendin e parë e zinte poezia. Por duke qenë se kjo prozë është mjaft e lidhur me situatat në Shqipëri dhe nevojat e të shprehurit në vend, nevoja që lindën nga situatë e reja. Këto situatë të reja kishin nevojë për formë të reja të të shprehurit. Me këtë nuk dua të them se vetë proza është pasqyrim i drejtpërdrejtë i nevojës, por me këtë dua të them që kjo prozë që sapo po lindte është një prozë e informacionit. Jo e informacionit gazetaresk, as shifror, as kronologjik. Kjo është një prozë e informacionit shpirtëror. E konceptuar në këtë mënyrë kjo lloj proze

sillte informacione mbi ndarjet e mëdha shpirtërore, mbi ndryshimet e mentaliteteve të ndryshme, mbi koncepte të etikës dhe estetikës në shoqëri etj. Mbi të gjitha kjo prozë me vetinë e informacionit ndikonte në përjetimet emocionale nëpërmjet ngjashmërisë dhe përkthente dëshirën njerëzore në dëshirë letrare. Kështu nëse në një prozë Lumo Skëndo trajton temën e kurbetit, ai nuk jep informacion kush dhe si shkojë njeriu në kurbet, çfarë ndodhi atje, pse ndodhi, sa kohë ndenji etj. Këto detaje janë të parëndësishme për autorin. Ai na jep informacion sesi e transformon kjo situatë gjendjen shpirtërore individuale, sesi kjo ndikon në ndryshimin e konceptit të familjes, kombit, sesi ndryshon shijet për natyrën, për dashurinë njerëzore, sesi njeriu fiton veti të reja sesi bëhet sfidant i durueshëm. Mbi të gjitha ai jep informacion sesi ky argument e bën një premisë siç është kënga që në vende të ndryshme por në njerëz të njëjtë të luajë të njëjtin rol. Ky është solida në letërsi, solida e personazhit. Kjo është prehja e personazheve të tij, prehje e cila ruan raporte të drejta me natyrën dhe temën përkatëse.

Romantizimi brenda prozës së Lumo Skëndos

Do të më pëlqente që pasi kam vënë në dukje shtjellimin e natyrës poetike të prozave të Lumo Skëndos të vë në dukje edhe një veti të re të saj, atë të ndikimeve të forta romantike, ndikime që në këtë rast konsiderohen pozitive, për shkak të pasojës së mirë që ato kanë në veprën e Lumo Skëndos. Është e natyrshme që rilindja e vonë të ruajë elementët e romantizmit të cilat në prozën e Lumo Skëndos janë të dukshme, por edhe e zgjedhojnë veten në forma të ndryshme. Kështu lirizmi si një element i romantizmit është prania shpirtërore e këtyre prozave. Kjo prani është e dukshme jo vetëm në zgjedhjen e temës, në zgjedhjen situative, por kjo është e qartë edhe kur flitet për natyrën, përshkrimin, botën e personazhit e kështu me radhë. Lirizmi i Lumo Skëndos ka natyrë poetike, siç dominon në të vërtetë edhe në rrymën romantike. Romantizmi i vërteti pati nevojë për poezinë e vërtetë. Kështu në këtë vazhdë, Lumo Skëndo u përfshi nga lirizmi duke reflektuar nota butësie dhe trishtimi. Shpesh është komentuar trishtimi i tij sentimental. Ky trishtim sentimental nuk është gjithëpërfshirës sepse vetëm në pak raste ai kalon në

pesimizëm të pakapërcyeshëm. Pjesa tjetër jep mesazhe të fuqishme shpirtërore. Por edhe dhënia e fuqishme e mesazheve shpirtërore është atribut i romantizmit. Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e krijimtarisë së tij dhe përcakton treguesin e tiparit romantik. Lirizmi shoqërohet me tone të forta të mesazhit, i cili ndonëse moralizues shndërrohet si pjesë e fortë, duke i dhënë patos shpërthimi prozës së Lumo Skëndos. Brenda këtij formati dhe kësaj natyre, ne kemi kërkuar te Lumo Skëndo këshillën, moralin, të cilin ai e promovon me shumë thjeshtësi duke e bërë atë të duket si moral i rastësishëm dhe rrjedhimor. Aftësia për ta bërë të thjeshtën koncept estetik është një tjetër tipar që shoqëron pamjen romantike. Kjo thjeshtësi zgjerohet nga formati emotiv ose ai i ndjenjës. Nuk do të thosha që ndjenja këtu kthehet në një kult, sikundër nuk do të thosha që ndjenja këtu është e fshehtë. Ajo është një ndjenjë e sapolindur dhe e paraqitur në shpërthim që gëlon rini, risi, dhe pasardhje. E dukshme me veten dhe mjaft figurative ajo të krijon idenë se bota e Lumo Skëndos është një botë ëndrre. Krijimi i konceptit të ëndrrës, duke kthyer këtë ndonjëherë në fatalitet dhe ndonjëherë në fantastike, e bëjnë këtë botë të jetë tepër emotive.

Konceptet: Estetika dhe Etika

Shpesh gjatë trajtimeve të veprës së Lumo Skëndos unë kam përmendur mjaft fjalën Koncept. Në fakt bota e prozës së tij është një botë konceptesh. Cilat janë këto koncepte dhe si trajtohen ato? Konceptet bazë janë konceptet e estetikës dhe të etikës. Këto dy botë lindin dhe zhvillohen te Lumo Skëndo duke u bërë si shtylla të forta të tipologjisë së tij. Kështu duke arritur të sjellë veten dhe botën e tij të ideve nëpërmjet etikës, Lumo Skëndo do të pranonte të ishte i duhur duke trajtuar konceptin e së mirës dhe të së keqes. Ky koncept në fakt i shkon për shtat përrallës si gjini letrare. Por Lumo Skëndo ka një tipar që e afron atë me këtë gjini. Ky tipar është moralizimi ose këshillimi. Duke qenë i tillë, Lumo Skëndo nuk e përdor veten aq sa të jetë i konsumuar në këtë rol, ose të jetë aq i konsumuar sa të dalë jashtë profilit letrar. Kështu ai këshillon mbi problemin e gjakmarrjes, apo mbi problemin e familjes, apo mbi problemin e kujtesës kombëtare. Nuk është e thënë që forma e tij e këshillimit të

vlejë vetëm për problemet dhe problematikat kombëtare, por kjo etikë vlen edhe për problemet shpirtërore siç janë problemi i dashurisë, i perceptimit të së bukurës, i durimit si proces etj. Në parim Lumo Skëndo moralin e jep që në titull, madje kjo është edhe mënyrë funksionimi tepër poetike. Por shpesh ai e jep në fund të prozës ose duke e përsëritur atë në fund pasi e ka dhënë në fillim ose midis saj. Ndodh që këshillimi të jetë gjatë gjithë prozës por të ketë vlerë simbolike. Jepet pasi është treguar një fakt që ka ose nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me të. Ndërsa ndryshe ndodh me konceptet estetike. Këto nuk janë konkluzione, por janë pjesë e brendshme e prozës së Lumo Skëndos. Pak përpara se të mendosh që kjo prozë është poetike, menjëherë i bashkëngjit edhe cilësinë ose tiparin e vlerave të estetikës. Ai merret në prozën e tij me të bukurën, me të shëmtuarën, me durimin, me fantastiken, me të zgjedhurën, me të veçantën etj. Të gjitha këto janë kategori estetike. Por cili është roli i tyre në këtë. Meqenëse Lumo Skëndo nuk ka subjekt dhe përmbajtje të mirëfilltë ai ka boshte dhe detaje. Të gjitha detajet e tij janë të lidhur ngushtësisht me një koncept, që qëllon të jetë estetik. Këto krijojnë brumin e këndshëm të këtyre prozave, duke e quajtur kështu këtë prozë një model të parë të së bukurës. Ato kultivojnë shije. Shija është parim themelor i estetikës, parim i cili rikrijon veten në dy plane, atë njerëzor dhe atë hyjnor, duke e bërë zbërthimin tërheqës, funksional dhe universal.

Fjala

Meqenëse fjala është buka e gjithçkaje të shkruar atëherë nuk ka sesi ne të mos merremi me këtë pjesë të dukshme dhe mjaft pozitive të tij, pjesë e cila të zgjon të drejtën për të bërë të gjitha reflektimet e tjera. Fjala te Lumo Skëndo ka force. Fjala te Lumo Skëndo është krijuesja e gjithçkaje. Fjala e tij është një shkallë e ndërmjetme, midis sjelljes poetike naimiane dhe vetë Lumo Skëndos. Kujtojmë prozat e tij poetike. Sa e sa herë ai përdor fjalët me pjesëza zvogëluese të cilat janë krijesa naimiane. Kujtojmë fjalët dhe shprehjet krahinore, të cilat janë një luks bukurie, feminiliteti, delikatese. Të gjitha këto e çojnë prozën e Lumo Skëndos në kriterin e thjeshtësisë, kuptueshmërisë, figurativitetit dhe qartësisë, tipare

këto mjaft të dukshme dhe të mëvetësishme. Kjo fjalë jep një gjuhë përshkruese, ambienti dhe ndodhie. Kjo fjalë jep prehjen dhe derdhjen e emocionalitetit. Kjo gjuhë e Skëndos shihet e lidhur me gjuhën e Faik Konicës.

Çfarë përftohet duke lexuar prozën e Lumo Skëndos?

Duke lexuar prozën e Lumo Skëndos përftohet një perceptim ambientor dhe situativ mbi vitet kur ajo u shkrua, përftohet një shije tepër e veçantë në vetinë e estetikës, përftohet një informacion kuptimor mbi poetikën e tij në varësi të idesë, përftohet njohja e diferencës midis zhanreve dhe mbi të gjitha përftohet përshkallëzimi i të menduarit.

Çfarë përftohet duke analizuar prozën e Lumo Skëndos?

Duke analizuar prozën e Lumo Skëndos përftohet atributi për të zbërthyer diferencat midis koncepteve, për të njohur stilin dhe natyrën e përshkrimit, për të fituar vetinë e heshtjes dhe të prehjes si edhe përftohet përballja midis llojeve të ndryshme letrare, përftohet psikologjia në zbërthime ritmike dhe dinamizmi emocional. Kështu duke analizuar prozën e tij, ne futemi thellë një procesi letrar duke vendosur dhe zhvendosur, pikat përshkruese, detajuese, figurative, fantastike në funksion vetjak.

Çfarë përftohet duke krahasuar prozën e Lumo Skëndos?

Përftesa e tretë është krahasimi i tipologjisë së tij me veten dhe të tjerët. Kjo tipologji është reflektuese, pasuese, rrjedhimore, dhe mjaft e lëvizshme. Sistemi i vlerësimit këtu mësohet me idenë që kjo lloj proze është e para e llojit të vet, është e veçantë dhe mjaft ndikuese.

Koha

Meqenëse folëm për të gjitha konceptet e Lumo Skëndos nuk mund të le pa përmendur edhe konceptin e kohës. Kur flisnim për kohën e Kutelit, të Rinë Katerinëza, kemi thënë që kjo është përfshirë në atë që quhet tejkohësia. Koha e tejkohësisë është e programuar për të na mbërthyer në kohën jashtëtokësore hyjnore, jo

të të gjallëve, të cilën e gjejmë edhe te Lumo Skëndo. Kjo lloj kohe është e pranishme kur trajtohen ëndrra, realiteti i shkuar, kur trajtohen ndjenjat dhe refleksionet që vijnë prej tyre. Kështu koha e tejkohësisë e pranishme te Lumo Skëndo jep pamjen e përrallave, fantasticitetin dhe madhështinë. Plaku i Ylynecit është një prozë në të cilën vetë koha është tejkohësi, vetë koha nuk ka formë është mjaft dinamike, e cila nuk mund të shihet kurrë në të njëjtën formë, me gjithë përmbajtjen e saj të njëjtë. Por këtu kemi edhe ndërthurjen e kohëve. Kemi kohën konkrete dhe kohën abstrakte. Kemi kohën në kuptimin e jetës dhe vdekjes, në kuptimin e ditës dhe vitit, në kuptimin e tre përmasave; e shkuar, e sotme, e ardhme. Kështu gjithpërmasia e kohës është refleksive dhe mjaft figurative. Koha është ajo që i jep prozës së Lumo Skëndos karakter fantastik, realist, poetik dhe meditativ.

Subjekti

Më pëlqen ta marr dhe ta trajtoj më vete konceptin e subjektit. Jemi në gjininë e prozës por në fakt nuk kemi një prozë tradicionale, një prozë thjeshtë kuptimore dhe të ndërtuar mbi subjekte, të cilat ndoshta janë të vetmit që mbahen mend duke lexuar prozën e Lumo Skëndos. Kështu imazhi që më mbete pasi kam lexuar këtë prozë nuk ka të bëjë me kujtesën subjektore ose të përmbajtjes. Nuk ka të bëjë me përmasën e renditjes kronologjike të ngjarjes dhe të personazheve që mbulojnë strukturat boshe të saj. Këtu kemi një prozë të fiksionit, e cila krijohet nga imagjinata e autorit dhe vetëm nga kjo imagjinatë. Kështu kjo lloj proze nuk na nxjerr në pamje të parë rutinën tregimtare, por mungesën e saj. Kjo mungesë në këtë rast konsiderohet vlerë, sepse kundrejt saj proza e Lumo Skëndos fiton atributet e një proze të mirëfilltë artistike dhe poetike. Ajo prozë në mungesë të këtij subjekti të mirëfilltë na jep detaje fantastike, moralizime estetike, figura simbolike, personazhe portrete me të cilët nuk lodhemi, sepse nuk kemi kohë për këtë, ajo fiton atributin e shkurtësisë, e cila e bën këtë të sundohet nga e papritura dhe kapërcimi. Kështu proza e Lumo Skëndos jep një format proze ku jeta është imazh dhe konsultat rreth saj janë realitete

të ndërtuara në modelet e së ardhmes njerëzore, ku dominon moderniteti paraqitës.

Kodet tematike

E gjithë kjo paraqitje ka në vetvete zbërthime të vogla, të cilat nuk do t'i quaja nëntema, por kode poetike, sepse synimi i tyre nuk është përmbajtja, por lidhja e përmbajtjes me objektin, siç ndodh me të vërtetë, në lidhjen e pastër gjuhësore. Kështu Lumo Skëndo e quan udhën njeri, sepse ajo e shoqëron njeriun gjatë rrugëtimit të tij. Po kështu ai e quan hënë dëshmitare, sepse ajo në fakt shikon gjithçka dhe hesht për gjithçka. Kështu loti është dhimbje dhe gëzim sipas funksionit tematik. Kështu shkrepja e armës është gjakmarrje, numërimi është përmasë dhe përsëritje, mugëtira është frikë dhe dilemë, ëndrra është paralajmërim, maji është lindje, vjeshta është rikthim, bujqësia dhe blegtoria është jetë, kafshët janë ekzistencë, kënga është dinamizëm dhe ritëm, shkëmbi është qëndresë, koha është përjetësi, shqiponja është rojtare e mirë dhe kështu me radhë. Të thënat mbi këtë janë të gjitha formatime poetike, të cilat nuk mund të reformojnë kuptimet fillestare. Ato janë ndërtuar si të tilla, për të dhënë rolin artistik dhe janë ndërtuar mbi bazën e shoqërizimit. E gjitha kjo të çon në një atribut mjaft specifik që vlen të merret në konsideratë. Kjo përcakton një cilësi të re të prozës së Lumo Skëndos, cilësinë e kodeve tematike artistike, të cilat sot karakterizohen nga ngurtësimi siç ndodh me mjaft fjalë e shprehje, të cilat janë pasuri e vërtetë popullore.

Shprehja e drejtpërdrejtë

Krijimi i kodeve letrare në të vërtetë zvogëlon kuptimin e drejtpërdrejtë të shprehjes kuptimore poetike a jo. Me këtë dua të them se pavarësisht krijimit të këtyre kodeve poetike është mjaft me rëndësi vlera e frazës së drejtpërdrejtë te Lumo Skëndo, frazë e cila ndërton një pjesë të mirë të prozave të tij. Këtë shprehi ne e gjejmë më vete dhe të përfshirë edhe në rastet e kodimeve të fjalëve dhe të shprehjeve. Kjo shprehje e drejtpërdrejtë karakterizohet nga sinqeriteti, nga thjeshtësia, nga këshillimi nga argumentimi e kështu me radhë. Kjo lloj të shprehuri është ndërthurje e cilësive që

përmendëm më lart dhe na sjell pranë kuptimin nëpërmjet leximit të detajuar, lexim i cili të Lumo Skëndos është dhe nuk është i mjaftueshëm.

Fjalët kyçe të prozave dhe roli i tyre. Shënjimi në titull

Dukuria e dhënies kuptimore që në titull është dukuri e prozave të Lumo Skëndos. Kjo lloj **dukurie përcjell efekte, të cilat lidhen së pari me kuptimin e drejtpërdrejtë, pastaj me kuptimin simbolik**, më pas me kufizimin në një ambient të ngushtë, ku mund të zhvillohet ideja. Pjesa tjetër brenda tij është prehje dhe lëvizje për këtë shënjim. Vetë titulli konsiderohet në shumicën e rasteve si fjalë kyçe, fjalë të cilat shërbejnë si bërthamë e prozës dhe në të njëjtën kohë janë edhe prezantime konceptesh të vetë autorit. Secila prej tyre është koncept dhe kuptim më vete. Të gjitha bashkë plotësojnë natyrën e prozës së Lumo Skëndos. Fjalë të tilla kemi shumë. Po përmendim kështu disa prej tyre. Tek proza “Udhëtimi” kemi: majin, udha, hëna, kënga, yjtë, delfinët etj. Tek proza: “Plaku i Ylynecit kemi: plaku, koha, shkëmbi, shqiponja etj. Tek “Ay mal” kemi: malin, plaku, djali, kaprolli, shqiponja etj. Luajtja me fjalët kyçe është edhe shenjë e një proze fillestare, edhe shenjë e një proze me ndikime të forta popullore, edhe shenjë moderniteti, pasi e bën atë simbolike, edhe shenjë kuptueshmërie që e bën atë të referueshme.

Efekti i rileximit

Kjo ndodh pasi i je rikthyer për qëllime të caktuara leximit të prozave të tij. Efekti që përfton nga rileximi është efekt jo vetëm që ka lidhje me kujtesën, por edhe me harresën artistike. Po cila është kjo harresë artistike? Kjo është harresa e dallimeve që mund të vesh re në leximin e parë. Në rilexim, prozat e Lumo Skëndos të duken më shumë si një e tërë, të cilat bashkohen së bashku nga shija e mirë që të lënë. Të rilexuarit të krijon idenë e fotografimit të qartë të skenave përshkrimore. Të marrurit me detajet e tyre të mrekullueshme, të gjendjeve në natyrë dhe në personazhe. Rileximi është një lloj rikthimi. Rikthimi analitik është i domosdoshëm për të krijuar lidhjen që kjo prozë ka me veten. Kështu të rilexuarit këtu aktivizon ritin e domosdoshëm të faktorëve vetëm e vetëm letrarë.

Dhe pas një rileximi, Proza e Lumo Skëndos të vendos në kufijtë e mendimit, midis komentarit dhe interpretimit, të cilat bëjnë të mundur vendosjen paralele të kuptimit, shijes dhe ndikimit që ato kanë. Ajo vjen si një prozë informative, personale dhe universale në të njëjtën kohë. Shqipëria, njeriu shkrihen bashkë, ku mjedisi, njeriu dhe dashuria bashkëjetojnë, ku figura dhe thjeshtësia gjenerojnë, ku fjala shqipe bëhet përherë e më e bukur. Nuk mund të ketë autorë të mëvonshëm që nuk i është referuar prozave të këtij autori.

Përmes prozës së Lumo Skëndos është e mundur të përvijohen mjaft tipare thelbësore të letërsisë së kësaj periudhe por edhe të mëvonshme, pasi proza e këtij autori përket me zanafillën e prozës së mirëfilltë. Ajo ndeshet me zhvillimet pozitive europiane, si edhe shfaq tipare të cilat reflektojnë elementet e mëvonshëm të prozës shqipe.

BIBLIOGRAFI

Or' e fundit, Nasho Jorgaqi.

Elita Shqiptare, Uran Butka.

Antologjitë e historisë së letërsisë shqipe.

Vepra e plotë e Lumo Skëndos, botimi në Kosovë.

Vepra e Lumo Skëndos, botime në Shqipëri.

F. Dado, *Proza nëpër Teknikat poetike*. 1997.

F. Dado, *Teoria e veprës letrare*, 1999.

A. Plasari, *Leksione të poetikës për pasuniversitarët*.

Letërsia bashkëkohore shqipe, A. Aliu, Sh. Sinani, S. Capaliku, T. Cobani, 2001.

Lektive mbi veprën e Lumo Skëndos. Përmbledhje.

Poetika. Aristoteli.

Struktura e papranishme. Umberto Eko. 1996.

Todorov. *Poetika e prozës*. 2001.

Midis malit dhe detit. Dh. Shehri.